Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1013

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani si kryetare duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "KIGA" Sh.P.K. me nr. 1013/23 të datës 14.12.2023 si dhe ankesën e operatorit ekonomik "NTP Burimi" me nr. 1015/23 të datës 14.12.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 29.11.2023 të Autoritetit Kontraktues - Spitali i Përgjithshëm Pejëlidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pelet" me numër të prokurimit 70030-23-8606-1-1-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve, me datë 29.01.2024 merr këtë:

Vendim

I. Hedhet si e palejuar ankesa e operatorit ekonomik "KIGA" Sh.P.K. me nr. 1013/23 e datës 14.12.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 29.11.2023 të Autoritetit Kontraktues - Spitali i Përgjithshëm Pejë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pelet" me numër të prokurimit 70030-23-8606-1-1-1.

II. Aprovohetsi e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "NTP Burimi" me nr. 1015/23 e datës 14.12.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 29.11.2023 të Autoritetit Kontraktues - Spitali i Përgjithshëm Pejëlidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pelet" me numër të prokurimit 70030-23-8606-1-1-1.

III. Anulohet Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues i datës 29.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me të dhënat si në pikën I dhe II të vendimit ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në **rivlerësim**.

IV.Detyrohet Autoriteti Kontraktues - Komuna e Podujevës për zbatimin e këtij vendimi si dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të vendimit të dërgoj në OSHP njoftimin lidhur me veprimet që ndërmerren për zbatimin e tij, të gjitha këto nën paralajmërimin se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, OSHP do të ndërmerr masat kundër Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 131 të LPP.

V.Lejohetkthimi i tarifave të ankesave në shumën e deponuar ashtu që obligohen operatorët ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtrojnë kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Spitali i Përgjithshëm Pejë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 14.08.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pelet" me numër të prokurimit 70030-23-8606-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 180,000.00 €.

Me datë 29.11.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka rekomanduar për kontratë grupin e operatorëve ekonomik "NTP Gresa Commerce & MBB Construction" Sh.P.K.

Të dy operatorët ekonomik ankues brenda afatit ligjor kanë parashtruar kërkesa për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin mirëpo autoriteti kontraktues përmes vendimeve përkatëse i ka refuzuar si të pabazuara këto kërkesa për rishqyrtim.

Me datë 14.12.2023 operatori ekonomik ankues "KIGA" Sh.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 1013/23 po ashtu me datë 14.12.2023 operatori ekonomik ankues "NTP Burimi" ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 1015/23.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 1013/23 dhe ankesa nr. 1015/23 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

OSHP lidhur me trajtimit ketij aktiviteti ka autorizaur dy ekspertiza dhe atë me datë 22.12.2023 dhe me datëm 21.01.2024, që të dy ekspertët kanë rekomanduar që ky aktivitet duhet të kthehet në Rivlersim tek Autoriteti i cili sipas tyre ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 dhe 72 të LPP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "KIGA" Sh.P.K. janë parashtruar si në vijim: "GOE i rekomanduar nuk e ka ofruar certifikatë teknike a2 origjinal ose kopje e noterizuar, por ka marre nga interneti certifikata dhe analiza te peletit dhe e ka bashkangjitur ne oferte, pra këto certifikata nuk janë ne emër te asnjërit prej operatoreve qe kane aplikuar ne këtë tender AK ne vend qe ta eliminoj këtë OE ne rastin konkret këtë OE e ka rekomanduar për kontrate edhe pse është i pa përgjegjshëm. GOE i rekomanduar është i pa përgjegjshëm pasi qe nuk e ka plotësuar formularin e tenderit siç duhet gjithashtu edhe nuk e ka dorëzuar listën e çmimeve dhe menjëherë është dashur te eliminohet sipas UPP konform nenit 10."Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues "KIGA" Sh.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59 dhe 60 të LPP. Operatori ekonomik ankues ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të miratohet ankesa ashtu që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "NPT Burimi" janë parashtruar si në vijim: "Në arsyetimin e Vendimit të AK thuhet se ne nuk kemi plotësuar kërkesat e FDT-së respektivisht: Oferta e juaj është e papërgjegjshëm dhe ka statusin e ofertës së eliminuar : Oferta e kompanisë tuaj: Te kërkesa 9.1&9.2 te FDT kërkesa 2 Certifikata ISO. Nuk keni dëshmi për ISO. Kjo nuk qëndron fare sepse ne posedojmë Certifikatën ISO të kërkuar me FDT dhe këto janë dëshmi të cilat mundë të verifikohen se kanë ekzistuar para datës së dorëzimit të ofertave dhe konform nenit 72 pika 3 është dashur të na kërkohen e jo të na eliminoni duke e dëmtuar buxhetin e AK në vlerë prej: 15600 euro. Certifikatat ISO janë dokumente të cilat mundë të verifikohen kur kanë ekzistuar dhe këto dëshmi AK është dashur që të ma kërkoj konform nenit 72.3." Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues "NTP Burimi" konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 59, 69 dhe 72 të LPP. Operatori ekonomik ankues ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të miratohet ankesa ashtu që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 22.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1013/23 ndërsa me datë 18.12.2023 Paneli Shqyrtues ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1015/23.Lidhur me ankesën nr. 1013/23 me datë 22.12.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/1013 me rekomandimet si në vijim: "ankesa të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim". Lidhur me ankesën nr. 1015/23 me datë 18.12.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/1015 me rekomandimet si në vijim: "ankesa të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim".

Paneli Shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave marr parysh natyrën e aktivitetit/sezonbale, lidhur me ankesën nr. 1013/23 dhe ankesën nr. 1015/23 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të përgatitur një super ekspertizë. Lidhur me ankesën nr. 1013/23 me datë 22.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues – super ekspertiza me nr. 2023/1013 me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hedhet poshtë si e palejuar". Lidhur me ankesën nr. 1015/23 me datë 22.01.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues – super ekspertiza me nr. 2023/1015 me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të

aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.”.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raportet e eksperteve shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

E**ksperti shqyrtues përmes raportit – super ekspertizës nr. 2023/1013** të datës 22.01.2024, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “KIGA” Sh.P.K ka vlerësuar shkurtimisht si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash, në kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmitë), konkretisht te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2, ka përcaktuar kërkesat (dokumentet) për Operatorët Ekonomik si më poshtë: Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për furnizime te njëjta, te realizuara ne tri vjetet e shkuara (20, 21, 22) para datës se publikimit te këtij njoftimi për kontrate, në vlere me se paku; 270000 euro. Ne rast konsorciumi lideri duhet te ketë te paktën 60% te vlerës se qarkullimit. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 1. OE duhet te ofroj dëshmi a). Listën e kontratave të realizuara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontrate) e nënshkruar dhe vulosur nga OE. b). Referencat ose raportet e pranimit te furnizimeve në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës , datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit. Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive ose raportet e pranimeve te furnizimeve është bërë për një autoritet publik apo privat në, për dëshmi duhet te dorëzohen raportet e pranimeve ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera) te lëshuara nga autoriteti i tillë. Eksperti Shqyrtues sqaron si në vijim: Në ofertën e dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik “KIGA SH.P.K”; “LIKI GROUP SH.P.K”, janë prezantuar lista e kontratave dhe lista e shitjes për lëndët djegëse PELET. Për ta sqaruar më mirë, nga OE “KIGA SHPK” është prezantuar lista me 64 kontrata në vlerë 769,129.39 euro të bashkangjitura me disa referenca për kontratat e përfunduara, ndërsa nga anëtari i këtij grupi-konzorciumi OE “LIKI GROUP SH.P.K”, është prezantuar lista e shitjes për lëndët djegëse PELET në vlerë 436,029.75 euro, si dhe me Fatura si dëshmi për realizimin e shitjes së lëndës djegëse PELET. Megjithatë sqarojmë se, kontratat e prezantuara në këtë listë nga OE “KIGA SHPK”, kontrata me numër rendor 6, 7, 41 dhe 64 janë kontrata për furnizime të njëjta sipas kërkesës në dosjen e tenderit e të cilat në vlerë totale janë 106,576.91 euro, andaj për këto kontrata ka bashkangjitur vetëm një referencë si dëshmi për furnizime të njëjta. Lidhur me kërkesën në fjalë, Eksperti shqyrtues sqaron se AK ka kërkuar që “Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për furnizime të njëjta, të realizuara ne tri vjetet e shkuara (20,21,22) para datës se publikimit te këtij njoftimi për kontrate”. Pra sipas kërkesës se lartë cekur në dosjen e tenderit, në kuptim të prokurimit publik: Termi “njëjtë” ka kuptimin e një furnizimi, shërbimi a punë të njëjtë (identike) me lëndën e kontratës, prandaj kontratat tjera në ketë listë meqenëse nuk janë kontrata për furnizime të njëjta, nuk mund të merret për bazë në llogaritje. Për më shumë, në lidhje me përkufizimin e termeve “të njëjta” dhe “të ngjashme” në kuptim të kontratave të realizuara në tri vitet e fundit, KRPP me datë 09.06.2023, ka dhënë një Opinion i cili është i publikuar tek pyetjet e shpeshta, përkatësisht opinioni me numër 11. Eksperti shqyrtues, gjithnjë duke u bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit, ku thuhet se “Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka

përfunduar me sukses kontrata për furnizime te njëjta, te realizuara ne tri vjetet shkuara (20,21,22) para datës se publikimit te këtij njoftimi për kontrate, në vlere me se paku; 270000 euro. Ne rast konsorciumi lideri duhet te këtë te paktën 60% te vlerës se qarkullimit", si dhe bazuar në atë që u tha më lartë, edhe për kundër se anëtari i konzorciumit OE "LIKI GROUP SH.P.K", ka prezantuar listën e shitjes për lëndët djegëse PELET në vlerë 436,029.75, megjithatë konsideroj se, bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit, lista e kontratave e prezantuara nga OE "KIGA SHPK", në këtë rast si lider i konzorciumit, nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit, rrjedhimisht Grupi i Operatorëve Ekonomik "KIGA SH.P.K"; "LIKI GROUP SH.P.K" është i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit. Ky konstatim mbështetet në faktin se, meqenëse AK në dosjen e tenderit me këtë kërkesë ka përcaktuar pragun se, "Ne rast konsorciumi lideri duhet te ketë te paktën 60% te vlerës se qarkullimit". Ndërsa OE "KIGA SHPK", duke qenë se në këtë aktivitet të prokurimit është përcaktuar si lider i konzorciumit, bazuar në dokumentacionin e prezantuar me ofertë, nuk ka ofruar dëshmi për kontrata për furnizime të njëjta, të realizuara në tri vjetet e shkuara për të paktën 60% të vlerës së qarkullimit sipas kërkesës së në dosjen e tenderit. Me tutje eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash, në kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmitë), konkretisht te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2, ka përcaktuar kërkesat (dokumentet) për Operatorët Ekonomik, si më poshtë: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale: Kërkesa 3. O.E OFERTUES DUHET TË DORËZOJË ANALIZËN TEKNIKE TË PELETIT A-TEST, KJO ANALIZË DUHET TË JETË NGA NJË INSTITUCION I LICENCUAR. DUHET TE POSEDOI CERTIFIKATË TEKNIKE N+A2. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 3. ANALIZËN TEKNIKE TË PELETIT A-TEST NGA NJË INSTITUCION I LICENCUAR- DUHET TE POSEDOI CERTIFIKATË TEKNIKE N+A2ORIGJINAL OSE KOPJE E NOTERIZUAR. Eksperti Shqyrtues, pas shqyrtimit dhe administrimit të shkresave të lëndës, fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, duke u bazuar në kërkesën e lartë cekur të dosjes së tenderit si arsye për eliminimin e OE ankues nga AK, sqaron se: AK në dosjen e tenderit ka kërkuar "O.E OFERTUES DUHET TË DORËZOJË ANALIZËN TEKNIKE TË PELETIT A-TEST, KJO ANALIZË DUHET TË JETË NGA NJË INSTITUCION I LICENCUAR. DUHET TE POSEDOI CERTIFIKATË TEKNIKE N+A2", Ndërsa, në ofertën e dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik "KIGA SH.P.K"; "LIKI GROUP SH.P.K" është prezantuar raporti i testimit për analizën teknike. Eksperti shqyrtues marrë parasysh atë që u tha më lartë, pretendimet ankimore të OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë nuk janë shqyrtuar fare, për faktin se, Grupi i Operatorëve Ekonomik "KIGA SH.P.K"; "LIKI GROUP SH.P.K" nuk ka prezantuar fakte dhe provë përkitazi me vërtetimin e fakteve të pohuara se nuk qëndron dhe/ose është kundërligjor vlerësimi i AK-së, rrjedhimisht është i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit, me titull: "FURNIZIM ME PELET" me nr. të prokurimit: "70030-23-8606-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Spitali i Përgjithshëm - Peje.

Prandaj, Operatori Ekonomik ankues "KIGA SHPK" mund të konsiderohet si palë pa interes juridik material, konform nenit 4.1.26, të LPP-së i cili përcakton: "Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar", gjithnjë duke u bazuar në sqarimet e lartë përmendura si dhe duke u bazuar në Njoftimin e OSHP-së të datës 09.02.2023 të publikuar në web faqen e OSHP-së, përkatësisht pika a), ku thuhet se: "a) Nëse ankuesi nuk prezanton asnjë fakt apo fakte dhe provë përkitazi me vërtetimin

e fakteve të pohuara se nuk qëndron dhe/ose është kundërligjor vlerësimi, respektivisht akti i atakuar i AK për eliminimin e tij/sajë dhe/ose nuk e argumenton faktin/pohimin bazë, se është i përgjegjshëm për aktivitetin e prokurimit për të cilin ka ushtruar ankesë". Gjithashtu, Eksperti shqyrtues sqaron se: Paragrafi 2 të nenit 24 të LPP-së përcakton, citojmë: "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj". Sipas nenit 59 të LPP-së, ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e Autoritetit Kontraktues ashtu që paragrafi 4 i nenit 59 të LPP-së, përcakton si në vijim, citojmë: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".

Sipas të thënave më sipër argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues të datës 22.01.2024 është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "KIGA" Sh.P.K. i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues.

Eksperti shqyrtues përmes raportit – super ekspertizës Nr. 2023/1015 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "NTP Burimi" ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti Shqyrtues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, gjithnjë duke u bazuar edhe në kërkesën e lartcekur në dosjen e tenderit, sqaron se: AK në dosjen e tenderit ka kërkuar "Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë EN – ISO 9001 2015 VEREJTJE CERTIFIKATAT E NATYRES SË NJEJTË (–ISO 9001) ME TE AVANCUARA PRANOHEN". Bazuar në formulimin e kësaj kërkese, AK në këtë kërkesë nuk ka specifikuar se OE ofertues duhet të ofroj në emër të tij "Certifikatën EN –ISO 9001 2015", pra në emër të OE ofertues, rrjedhimisht sipas këtij përshkrimi të kërkesë në fjalë në dosjen e tenderit, konsideroj se, kërkesa si e tillë është lënë e hapur nga AK. Duke qenë se, AK në dosjen e tenderit nuk ka kërkuar Certifikata EN –ISO 9001 2015 të jetë në emër të Operatorëve Ekonomik ofertues, OE ankues ka dorëzuar ISO standardi 9001:2015 Sistemin e menaxhimit të cilësisë valide në emër te Operatorit Ekonomik "HD& Pelet", rrjedhimisht bazuar në sqarimet e lartë cekura OE ankues e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Ky konstatim mbështetet në faktin se: Paragrafi 3 i nenit 56 të LPP-së përcakton: "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Eksperti shqyrtues sqaron se, për këtë aktivitet të prokurimit, shihet se OE "N.P.T. Burimi", është mbështet në kapacitet e një OE tjetër, ky konstatim bazohet në faktin se, në dokumentacionin e prezantuar në ofertë nga OE ankues, sepse lidhur me Kërkesën Nr. 3 "Kërkesa 3. O.E OFERTUES DUHET TË DORËZOJË ANALIZËN TEKNIKE TË PELETIT

A-TEST, KJO ANALIZË DUHET TË JETË NGA NJË INSTITUCION I LICENCUAR. DUHET TE POSEDOI CERTIFIKATË TEKNIKE N+A2", sipas kërkesës në fjalë, OE ankues "Analiza teknike të Peletit" e ka dorëzuar në emër të Operatorit Ekonomik "HD& Pelet", rrjedhimisht ky dokument për AK-në në këtë rast ka qenë i pranueshëm. Prandaj bazuar në sqarimet e lartë cekura, konsideroj se, AK gjatë vlerësimit të tenderit, nuk duhet të ketë standarde të dyfishta të vlerësimit për kërkesat e dosjes së tenderit të cilat nuk janë të specifikuara qartë. Në përputhje me nenin 17.12 të RRPP-së, "...Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre....". Dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe legjislacionit dytësor kërkojnë nga Autoriteti Kontraktues qe kriteret, kushtet, kërkesat dëshmitë dhe specifikimet në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë ti specifikojnë në mënyrë të qartë jo diskriminuese dhe të kuptueshme për Operatorët Ekonomik. Dosja e Tenderit është dokumenti kryesor mbi bazën e të cilës ofertuesi përgatitë ofertën e tij, prandaj edhe oferta vlerësohet nga AK në bazë të kërkesave, kushteve dhe kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në njoftim për kontratë.

Lidhur me mbështetjen në kapacitetet financiare, teknike dhe/ose profesionale, Eksperti shqyrtues sqaron se: Paragrafi 4 i nenit 68 të LPP-së në lidhje me gjendjen ekonomike dhe financiare, përcakton: Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai duhet në këtë rast të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete për këtë qëllim. Në kushte të njëjta, një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështeten në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup të subjekteve të tjera". Të njëjtën përcakton edhe paragrafi 8 i nenit 69 të LPP-së në lidhje me aftësinë teknike dhe/ose profesionale. "8. Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai në këtë rast duhet të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete në vend burimet e nevojshme në dispozicion të operatorit ekonomik. Nën të njëjtat kushte një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjekte të tjera".

Bazuar në dispozitat e lartë cituara, një kompani (Operator Ekonomik në kuptim të këtij ligji) lejohet të mbështet në kapacitetet financiare, teknike dhe profesionale nga një kompani tjetër në përputhje me paragrafin 4 të nenit 68, dhe paragrafin 8 të nenit 69 të LPP-së në mënyrë që tenderi i tij të jetë në përputhshmëri me kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë siç kërkohet me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së.

Lidhur me sqarimet e tenderit, paragrafi 1 i nenit 72 të LPP-së përcakton: "Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomik është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomik qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës".

Pra, në përputhje me paragrafët 1, 2 dhe 3 të nenit 72 të këtij ligji, AK-të mund të kërkojnë nga OE-të që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë ndonjë dëshmi të specifikuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji, Sigurimi

i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderit dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Pra, sipas dispozitave të cekura me lartë, për çdo dëshmi të kërkuar sipas nenit 65-71 të këtij ligji, AK mund të kërkojë sqarime shtesë nga OE-të në përputhje me nenin 72 të LPP-së. Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në të gjeturat dhe sqarimet e lartpërmendura, po ashtu marrë parasysh shkresat e lëndës të paraqitura në këtë raport, si dhe duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit konsideroj se, AK nuk ka bërë vlerësimin e tenderit në pajtim me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së. Paragrafi 4 i nenit 59 të LPP, përcakton: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".

AK lidhur me ekspertizën e pranuar për ankuesin KIGA SHPK ka deklaruar si në vijim: Lidhur me ekspertizën të datës: 22.12.2023, nr. 2023/1013, për tenderin "FURNIZIM ME PELET" me nr. të prokurimit: "70030-23-8606-1-1-1", AK – Spitali i Përgjithshëm- Peje deklaron se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit. kurse lidhur me ankuesin "N.P.T. Burimi",Lidhur me ekspertizen të datës: 28.12.2023 për tenderin "FURNIZIM ME PELET" me nr. të prokurimit: "70030-23-8606-1-1-1", AK – Spitali i Përgjithshëm- Peje deklaron se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit për arsyet si ne vijim Ekspertja shqyrtuese nuk ka analizuar që Këto ISO standarde nuk janë në emër të kompanisë ankuese BURIMI, këto ISO standarde janë në emër te operatorit ekonomik HD& Pelet, i cili nuk është pjesëmarrës ne këtë aktivitet të prokurimit, dhe si të tilla janë të papranueshme. Kurse sa i përket raportit të superkespertizes lidhur me GOE KIGa ka deklaruar se pajtohet kurse lidhur me OE Burimi jo me atrsyetimit e njejtë si më sipër.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues sipas raportit të superkespertizes të datës 22.01.2024, -paneli gjykon se i njëjti i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues "NTP Burimi". Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "NTP Burimi" i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP.

Në fazën e shqyrtimit paraprak, lidhur me ankesën e prashtuar nga GOE "KIGA SH.P.K"; "LIKI GROUP SH.P.K" OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është parashtruar brenda afatit ligjor sikurse parashihet me nenin 109 paragrafi 1 dhe është ushtruar pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse kërkohet edhe kjo në kuptim të nenit 108/A të LPP, megjithatë ankesa nuk i përmban të gjitha elementet qenësore të parapara me dispozitën e nenit 111 të LPP. Në të vërtetë sipas paragrafit 1.5 të nenit 111, kërkohet që ankuesi ta vërtetoj faktin, cituar: "se kualifikohet si "palë e interesuar" siç është përkufizuar kjo shprehje në nenin 4 të këtij ligji". Kurse sipas nenit 4, paragrafi 1.26. parashihet shprehimisht se palë e interesuar, konsiderohet personi [nënkupto: fizik dhe/ose juridik] i cili siç thuhet, cituar "mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose...".

Në ketë rast, shikuar në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të kësaj lënde, rrjedhës së aktivitetit të prokurimit akteve dhe veprimeve të palëve të përfshira, është jo kontestues fakti se ankuesi është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit me vendimin tani të atakuar të autoritetit kontraktues. Mirëpo ankuesi nuk e ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të autoritetit kontraktues mbi bazën e shkaqeve dhe arsyeve të cilat kërkohet shprehimisht me paragrafin 1.8. të nenit 111, të LPP, sipas të cilit kërkohet nga ankuesi, cituar: "të përshkruajë mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës..." Kështu, në kontekstin e shpjegimeve si më sipër, OSHP vëren se:

- se ankuesi nuk e ka ushtruar ankesë për të dëshmuar interesin material, të tij/saj, sikurse kërkohet kjo me paragrafin 1.26. të nenit 4;
- nuk e ka ushtruar ankesën në harmoni me paragrafin 1.8 të nenit 11, sipas të cilit kërkohet që të përshkruajë mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose mund t'i shkaktojë dëme materiale;

Duke i analizuar të gjitha këto, OSHP në ketë rast konsideron se duhet i referohet dispozitës se nenit 31, paragrafi 2, të Rregullores për punën e Organit Shqyrtues të Prokurimit, sipas të cilit, cituar: "...Paneli duhet ta konsideroj ankesën si të pa bazuar edhe nëse po të mos kishte asnjë shkelje të ligjit, ankuesi nuk do të kishte gjasa për fitimin e tenderit". Prandaj në rastin konkret, konstatohet se ankuesi nuk e ka statusin e palës së interesuar, i cili konsiderohet kusht i domosdoshëm për shqyrtimin dhe vendosjen meritore në kuptim të nenit 105 të LPP, sipas të cilit OSHP ka kompetenca, autoritet, pushtet dhe përgjegjësi, në kuadër të kushteve të saktësuara në këtë Pjesë IX që ti shqyrtojnë ankesat nga, cituar "palët e interesuara".Grupi i Operatorëve Ekonomik "KIGA SH.P.K"; "LIKI GROUP SH.P.K" nuk ka prezantuar fakte dhe prova përkitazi me vërtetimin e fakteve të pohuara se realisht sipas tij/saj nuk qëndron dhe/ose është kundërligjor vlerësimi i AK-së, andaj rrjedhimisht është i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Sa i përket pretendimeve të OE"NTP Burimi", Paneli Shqyrtues bazuar në raportin e dy ekspertëve shqyrtues, ka gjetur se AK në dosjen e tenderit nuk kishte kërkuar shprehimisht Certifikata EN –ISO 9001 2015 të jetë në emër të OE, kurse nga ana tjetër Ankuesi në ofertën e tij/saj ka prezantuar ISO 9001:2015 [Sistemin e menaxhimit të cilësisë] valide në emër te OE "HD& Pelet", Lidhur me këtë ekspertet kane rekomanduar që AK në procedurë rivlerësimi për çdo dëshmi të kërkuar sipas nenit 65-71 të këtij ligji, mund të kërkojë sqarime shtesë nga OE-të në përputhje me nenin 72 të LPP-së.

Andaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në të gjeturat dhe sqarimet e lartpërmendura, po ashtu marrë parasysh shkresat e lëndës të paraqitura në këtë raport, si dhe duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit sqaron se, AK nuk ka bërë vlerësimin e tenderit në pajtim me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së. Paragrafi 4 i nenit 59 të LPP i cili përcakton: "...Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit..." Është jo-kontestuese po ashtu se AK ka bërë vlerësime me standarde të dyfishta duke vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP, ashtu siç janë shpjeguar si më sipër nga ana e ekspertit shqyrtues pa nevojë që të njëjtat të citohen sërish. Paneli sqaron se AK duhet gjithnjë ta ketë parasysh dhe të veproj në përputhje me nenin 17.12 të RRPP-së cituar "...Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre....". Dispozitat e LPP-së dhe legjislacionit dytësor kërkojnë nga AK qe kriteret, kushtet, kërkesat dëshmitë dhe specifikimet në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë ti specifikojnë në mënyrë të qartë jo diskriminuese dhe të kuptueshme për Operatorët Ekonomik. Dosja e Tenderit është dokumenti kryesor mbi bazën e të cilës ofertuesi përgatitë ofertën e tij, prandaj edhe oferta vlerësohet nga AK në bazë të kërkesave, kushteve dhe kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në njoftim për kontratë.

Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues, ka gjetur se ankesa GOE""KIGA SH.P.K"; "LIKI GROUP SH.P.K". duhet të hedhet si e palejuar ndërsa ankesa e OE "NTP Burimi" duhet të aprovohet si e bazuar , rrjedhimisht paneli ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e datës 29.11.2023 të AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pelet" me numër të prokurimit 70030-23-8606-1-1-1, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në **rivlerësim**.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Paneli thekson se Dosja e Tenderit është dokumenti kryesor mbi bazën e të cilës ofertuesi përgatitë ofertën e tij, oferta duhet të vlerësohet nga AK në bazë të kërkesave, kushteve dhe kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në njoftim për kontratë në zabtim të nenit 7 lidhur me nenin 56.3 të LPP-s-së.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore e në kuptim të nenit 1,6, 7, 103, 104 paragrafi 1 nenin ,105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Lidhur me tarifën ankimore është vendosur konform nenit 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **Spitali i Pergjithshem- Pejë, Spitali i Pergjithshem- Pejë**
- OE - **" KIGA " SH.P.K., N.P.T. " Burimi "**
- Arkivës së OSHP-së: